



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3785 prot.

B.Curri, më 29.092025

VENDIM

Nr 60 Datë 25. 09.2025

“Për Miratimin e Projekt-Idesë për Ndërtimin e Segmentit Rrugor “Ura e Mërturit – Curraj i Epërm’ Me Degëzim “Mulaj – Gecaj – Qereç”

Këshilli i Bashkisë Tropojë , në mbledhjen e tij të datës 25.09. 2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë në mbështetje të pika 2 të nenit 8, të nenit 9 pika 1/1 shkronja “b”, nenit 23 pika 4 dhe 14; të Ligjit Nr.139/215 datë 17.12.2015 Për “Vetëqeverisjen Vendore”, (i ndryshuar); Ligjit nr 9270 dt 29.07.2004 “Per sistemin e adresave” (i ndryshuar); shkronja “F” e pikës 2 të Ligjit 8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugore i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar); Ligji Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” (i ndryshuar); VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” (i ndryshuar); VKM nr.555 date 07.05.2008 “Per miratimin e listes perfundimtare te pronave, pyje dhe kullota, qe do te transferohen ne pronesi te njesise se qeverisjes vendore, Komuna Lekbibaj , te Qarkut Kukes”; VKM 928 date 02.07.2008 “Per miratimin e listes perfundimtare se inventarit te Pronave te Paluajtshme Shtetore ne Komunen Lekbibaj, te Qarkut te Kukesit” ; kërkesës së paraqitur nga “Unioni për Vendlindjen Curraj i Epërm”, përfaqësuar nga përfaqësues të komunitetit dhe kryepleqtë e zonës të protokolluar pranë Bashkisë Tropojë me nr.3050 Prot. date 07/07/2025 si dhe kërkesës së paraqitur nga “Unioni për Vendlindjen Curraj i Epërm” për depozitim projekti i rrugës “Ura e Mërturit – Curraj i Epërm” me degëzimet “Mulaj – Gecaj – Qereç” të protokolluar pranë Bashkisë Tropojë me nr.3034 Prot. date 04/07/2025

VENDOSI

1. Miratimin e **projekt-idesë** për ndërtimin e rrugës “Ura e Mërturit – Curraj i Epërm” (me gjatesi 8.22 km) me degëzimet “Mulaj – Gecaj – Qereç” (me gjatesi 6,45 km) , me gjatësi totale 14.67 km sipas projektit dhe relacioni teknik bashkngjitur . Traseja e rruges kalon ne pasurite si vijon

Segmenti Ura e Merturit – Curraj i Epërm: pasuritë nr. 573, 578, 574, 556, 569, 556, 104, 501, 577, 502/902, 502/901, 502/899, 502/898, 502/896, 502/888, 502/889, 502/893, 502/892, 502/891, 502/826, 502/825, 502/977, 502/341 si dhe pasuri qe nuk iu kane nenshtruar akoma rregjistrimin fillestar por jane ne process certifikimi

Degëzimi Qerrec – Mulaj: pasuritë nr. 568, 556, 109, 527, 553, 511/235, 511/232, 511/231, 104, 501, 511/206, 116, 511/207, 221, 511/147, 111, 511/132, 511/77, 347, 346, 511/75, 511/74, 345, 343, 511/70.

2. Financimi i këtij projekti do të synohet përmes përfshirjes në **buxhetin e shtetit ose aplikimit për fonde nga organizata zhvillimore dhe donatorë të huaj**, në bashkëpunim me grupin e interesit.
3. Në rast konstatimi të nevojës për shpronësime, ato do të planifikohen dhe realizohen sipas procedurave ligjore në fuqi, në përputhje me **Nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm publike” (i ndryshuar)**, si dhe aktet nënligjore përkatëse.
4. Te ndiqen te gjitha procedura ligjore qe nevojiten per pajisjen me leje infrastrukture.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas pikës 6 të nenit 55 Ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen Vendore
6. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit , Drejtoria Ekonomike dhe Sektori Juridik per zbatimin e ketij vendimi.

Shpallur me 29.09.2025, Miratuar me 15 vota, Vota Pro 15, Vota Kunder 0, Vota Abstenim 1

SEKRETARI
Ergent GJONGECAJ



KRYETARI
Arber ÇAKRAJ

